



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Drejtuar: Shoqërisë “IT Gjergji Kompjuter” shpk
Adresa: Tirane, Rruga Dervish Hima, Prapa ish Televizionit Klan.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Procedura e prokurimit: e zgjedhur Në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Neni 35/1, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu IV, Neni 33; si dhe Kreut V, Neni 45, pika 1, rekomandimit Nr. 13566 Prot dt 06.11.2017 nga Agjensia e Prokurimit Publik dhe udhëzimit Nr. 6 dt 16.01.2018 për ”Përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” është **“Procedurë e Hapur/marrëveshje kuader”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje materiale kancelarie, dhe materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës për Bashkinë e Tiranës për vitin 2018”** i ndarë në lote si më poshtë vijon:

REF-52672-02-28-2018

Loti II: Blerje materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës për Bashkinë e Tiranës për vitin 2018

i) **Loti II: Blerje materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës për Bashkinë e Tiranës për vitin 2018**, ku vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër (në total për lotin e dyte) është **11.981.535 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë)** lekë pa T.V.SH.

Burimi i financimit: Të ardhura - vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin

2018”.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **03.04.2018**, ora **11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr 9 datë 05.03.2018**.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë për lotin e parte këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk NUIS- **J62426002Q**

Vlera e ofertës pa TVSH është **8.447.116**(tetë million e katërqind e dyzetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë)leke .

2. Operatori ekonomik “Interlogistic” shpk NUIS **K21605003M**

Vlera e ofertës pa TVSH është **11.114.540**(njëmbëdhjetë million e njëqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet) leke.

3. Operatori ekonomik ” IT Gjergji Kompjuter” shpk NUIS- **K81503063B**

Vlera e ofertës pa TVSH është **11.307.711**(njëmbëdhjetë million e treqind e shtatë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) leke.

4. Operatori ekonomik ”Marketing & Distribution” shpk NUIS- **J72124001N**

Vlera e ofertës pa TVSH është **11.892.558** (njëmbëdhjetë million e tetëqind e nënrëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë) leke.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm për lotin e pare:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk

Për arsyet si më poshtë vijon:

Tek kërkesat për kualifikim “kapaciteti teknik” përcaktohet se:

“ Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për cdo artikull të kërkuar në preventiv për lotin e dyte. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.Mosparaqitja e mostrave është kusht për s’kualifikim”.

Në dt. 03.04.2018 ora 11.00 që përkon me ditën dhe orën e hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mori në dorëzim mostrat e paraqitura nga shoqëria “Infosoft Office” shpk në mbështetje të VKM.Nr.914, datë 29.12.2014 Kreu III, neni 27 pika 6 gërma (a) nga ku

konstatoi se Operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk nuk ka paraqitur të plota mostrat sipas artikujve të përcaktuar në preventivin e vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë. Konkretisht u konstatuan keto mangësi në mostrat e paraqitura nga shoqëria “Infosoft Office” shpk

1. Operatori i mësipërm ekonomik nuk ka paraqitur mostra për zërin, artikullin Nr. 31(Samsung SCX 4521 MLT-D119S/ELS) ndërsa për artikullin 62 (Canon I-Sensys Mf 8330 cdn (Set 4 ngjyra) mungojnë ngjyrat e kërkuara, ç’ka bie në kundërshtim me kriterin sa më sipër cituar ku thuhet se operatori ekonomik duhet te paraqese mostra për cdo artikull të kërkuar në preventiv për lotin e dytë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pas konstatimit të *mosparaqitjes së plotë të mostrave sipas artikujve pjesë e preventivit*, vendosi ta shpallë të pavlefshme ofertën e paraqitur për lotin e dytë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Interlogistic” shpk

Për arsyet si më poshtë vijon:

Tek kërkesat për kualifikim “kapaciteti teknik” përcaktohet se:

“ Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për cdo artikull të kërkuar në preventiv për lotin e dyte. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mosparaqitja e mostrave është kusht për s’kualifikim”.

Në dt. 03.04.2018 që përkon me ditën dhe orën e hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mori në dorëzim mostrat e paraqitura nga shoqëria “Interlogistic” shpk në mbështetje të VKM.Nr.914, datë 29.12.2014 Kreu III, neni 27 pika 6 gërma (a) nga ku konstatoi se Operatori ekonomik “Interlogistic” shpk nuk ka paraqitur të plota mostrat sipas artikujve të përcaktuar në preventivin e vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë. Konkretisht u konstatuan keto mangësi në mostrat e paraqitura nga shoqëria “Interlogistic” shpk

1. Operatori i mësipërm ekonomik nuk ka paraqitur mostra për zërat 12, 25, 27, 47, ndërsa për zërin 10 ku është kërkuar të paraqitet (HP Desk Jet 6540 (339)) blc C8767 EE është paraqitur mostra (HP Desk Jet 6540 (338)) blc C8767 EE. Për artikullin Nr. 11 është kërkuar të paraqitet (HP Desk Jet 6540 (344) col C9363 EE) nderkohe është paraqitur mostra (HP Desk Jet 6540 (343) col C9363 EE), ç’ka bie në kundërshtim me kriterin sa më sipër cituar ku thuhet se operatori ekonomik duhet te paraqese mostra për cdo artikull të kërkuar në preventiv për lotin e dytë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu

VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pas konstatimit të ***mosparaqitjes së plotë të mostrave sipas artikujve pjesë e preventivit***, vendosi ta **shpallë të pavlefshme ofertën e paraqitur për lotin e dytë**, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” shpk

Për arsyet si më poshtë vijon:

Tek kërkesat për kualifikim “*kapaciteti teknik*” përcaktohet se:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për cdo artikull të kërkuar në preventiv për lotin e parë. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mosparaqitja e mostrave është kusht për s’kualifikim”.

Në dt. 03.04.2018 që përkon me ditën dhe orën e hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mori në dorëzim mostrat e paraqitura nga shoqëria “Marketing & Distribution” shpk në mbështetje të VKM.Nr.914, datë 29.12.2014 Kreu III, neni 27 pika 6 gërma (a) nga ku konstatoi se Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” shpk nuk ka paraqitur mostrat sipas artikujve të përcaktuar në preventivin e vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pas konstatimit të ***mosparaqitjes së të gjitha mostrave sipas artikujve pjesë e preventivit***, vendosi ta **shpallë të pavlefshme ofertën e paraqitur për lotin e dytë**, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit duke mos i hyrë shqyrtimit të dokumentacionit tjetër të paraqitur nga kjo shoqëri për ekonomi të procedurës si edhe për vetë faktin se mosparaqitja e mostrave është kusht për s’kualifikim.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar **si operator ekonomik i suksesshëm për lotin e dytë :**

5. Operatori ekonomik ” IT Gjergji Kompjuter” shpk

NUIS- K81503063B

Vlera e ofertës pa TVSH është **11.307.711(njëmbëdhjetë million e treqind e shtatë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) leke.**

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.04.2018.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk

4

është paraqitur asnjë ankesë me shkrim.

